



JETËSHKRIM

Dr. Alket Hyseni

Dr. Alket Hyseni është diplomuar në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë me rezultate të shkëlqyera në vitin 1999. Po ashtu, në vitin 2007 është diplomuar në Universitetin e Gjirokastrës, Dega Kontabilitet- Financë.

Gjatë viteve 2001-2006 ka kryer studimet Master për “International Law” dhe “Doktor i Shkencave Juridike” në “International Business Law” në Leibniz University, Santa Fe, New Mexiko, USA.

Ka kryer disa kurse dhe kualifikime profesionale aftshkurtra, brenda dhe jashtë vendit.

Dr. Alket Hyseni ka punuar në pozicione të ndryshme drejtuese në Drejtorinë e Pëgjithëshme të Doganave, si dhe prej vitit 2006 Drejtor i Studio Ligjore “H&A”.

Gjithashtu, ka punuar si Lektor në Universitetin jopublik “Justiniani I”, Universiteti “Biznesi”, Prishtinë, si dhe Lektor dhe Përgjegjës i Departamentit të Drejtësisë në Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës.

Është Dekan i Fakultetit të Shkencave Politike dhe Juridike në Universitetin “Aleksandër Moisiu” që nga krijimi i këtij Fakulteti.

Është autor dhe bashkëautor i disa teksteve, ndër të cilat “Të Drejtat e Njeriut në Kushtetutën Shqiptare”, “Ligji Doganor”, “E drejta civile romake si themel për të drejtën familjare”, etj. Gjithashtu është autor i shumë artikujve të tjerë shkencorë, të botuar në revista prestigjioze brenda dhe jashtë vendit.